



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. Prot. 01-2904/15
 Br. Prot. 05
 Prot No. 25
 Data 09-2015
 Datum 25
 Date 09-2015
 PRISHTINE

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	25.09.2015
REFERENC-Ë:	DPK- DPKPP-03-03/583/15
PËR/ZA/TO:	z. Selami BERISHA Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
CC:	z. Nazmi ZENELAJ Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Laboratori i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës "



I nderuari z. Berisha ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Laboratori i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës " me numër prokurimi: 43900-15-024-111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Laboratori i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës " me numër prokurimi: 43900-15-024-111, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsy etimi

Ministria e Zhvillimit Ekonomik si Autoritet Kontraktues, përmes Divizionit të Prokurimit ka iniciuar procedurën e prokurimit me titull "*Laboratori i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës*" me numër të prokurimit 43900-15-024-111, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.25.05.2015 dhe me dt.22.06.2015 është bërë zgjatje e afatit për dorëzimin e ofertave. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e hapur, kontratë të llojit furnizime me vlerë të madhe.

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka trajtuar këtë procedurë të prokurimit ku gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve në dispozicion për këtë tender, ka hasur në disa kërkesa të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia pasi ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes dokumentet përkatëse të kësaj procedure të prokurimit ka konstatuar se njëri nga Operatorët ekonomik i cili ka tërhequr dosjen e këtij tenderi ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit kundër njoftimit për kontratë. Operatori Ekonomik ndër të tjera ka kërkuar që tenderi të ndahet nga 1 lot në 5 lote me pretendimin se janë 5 pozicione dhe artikuj të ndryshëm. Me dt.25.06.2015 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka nxjerrë vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e Operatorit ekonomik.

Gjatë analizimit të Raportit përfundimtar në lidhje me ankesën i përgatitur nga Ekspertja Shqyrtuese dhe Vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit ka vërejtur se në raportin përfundimtar në lidhje me pretendimet e palës ankuese në këtë rast Ekspertja Shqyrtuese kishte konstatuar se duke u bazuar në Rregulloren për Prokurimin Publik neni 2 paragrafi 4 ku thuhet se "*Në rast të kontratave të përbëra nga një sërë punësh, mallrash ose shërbimesh homogjene që i shërbejnë një qëllimi të njëjtë dhe kur vlerat e kombinuara janë të atilla ku vetëm një numër i vogël i Operatorëve ekonomik do të ishin në gjendje t'i siguronin ato, kontrata mund të ndahet në pjesë (lote)*". Ndarja në lote mund të bëhet në mënyrë që të inkurajohet pjesëmarrja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për të kursyer resurse përmes reduktimit të numrit të tenderëve. Eksperti Shqyrtues mendon se nuk është ndonjë shkelje ligjore pasi që është e drejtë e Autoritetit Kontraktues të vendosë për ndarjen apo mos ndarjen e tenderit në lote, por meqë ka të bëjë me 5 pozicione të ndryshme të pajisjeve gjeologjike për shkak të transparencës më të madhe për mundësinë e pjesëmarrjes më të madhe të Operatorëve ekonomik është dashur që këtë tender ta ndaj në 5 lote, sepse secila është pjesë e një rëndësie të vetë (pra janë pozicione të ndryshme njëra me tjetrën). Ekspertja Shqyrtuese i ka propozuar Panelit të OSHP-së që ta aprovojë si të pjesëshme ankesën duke e detyruar Autoritetin Kontraktues ta bëjë ndarjen e këtij tenderi në 5 lote dhe ritenderimin e tij. Megjithatë Paneli Shqyrtues i Prokurimit ka nxjerrë vendim mbi refuzimin e ankesës si të pabazë duke i lejuar Autoritetit kontraktues që të vazhdojë tutje me procedurën e prokurimit.

Agjencia Kundër Korrupsionit duke e parë rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit me dt.06.07.2015 ka paraqitur Njoftimin për pjesëmarrje në vëzhgim, përmes së cilit e ka njoftuar Autoritetin Kontraktues se Përfaqësuesi i Agjencisë Kundër Korrupsionit do të marrë pjesë në ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve në cilësinë e vëzhguesit. Agjencia pasi ka ekzaminuar dokumentet në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit dhe pasi ka marrë pjesë në cilësinë vëzhguesit ka konstatuar të gjeturat si në vijim:

Në Dosjen e Tenderit që ka përgatitur Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit, tek pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme ka paraparë furnizimin me 5 pajisje si në vijim: **Difraktometer me rreze X**, i konfiguruar për aplikim në kristalografi/mineralogji/gjeologji, **Spektrometër i Masës ICP-MS** për analiza kimike, aplikim në gjeologjike/gjeokimi, **Sistem për pastrimin dhe dejonizimin e ujit, Sistemi për pastrimin e ajrit, Sistemi mikrovalor për digjestim (Sistemi për përgatitjen e mostrave)**. Dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 12 Operatori ekonomik ku 4 prej tyre i kanë dorëzuar ofertat e tyre për këtë kontratë.

Agjencia Kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes specifikimet teknike që janë përpiluar për këtë tender konstaton se autoriteti kontraktues ka përshkruar specifikime teknike të cilat janë favorizuese për një prodhues dhe në të njëjtën kohë specifikimet e tilla mund ti eliminojnë disa prodhues tjerë të këtyre pajisjeve. Autoriteti kontraktues ka përshkruar këto specifikime si në vijim: Matja e diametrit të qarkut (varësisht nga aksesoret): Pozicion të parafinuar në 500, 560, 600 mm apo në rregullime intermediare, rang këndor: 360° (pa aksesor), Rangu i përdorshëm këndor: -110° to 168° (varësisht nga aksesoret), Shpejtësia këndore maksimale: 20°/s (varësisht nga aksesoret), Detektor silicon shirit me 192 shirita, dritarja aktive: 14.4 mm x 16 mm, njohja maksimale e numërimit: >100,000,000 cps, Rrezatim Cr, Co, Cu, Mo, dhe Ag. Efektiviteti është >99% për rrezatim Cr dhe Co, >98% për Cu rrezatim, ~40% për rrezatim të Mo dhe ~20% për rrezatim të Ag, Shpërndarja e energjisë <680 eV për rrezatim të Cu, Rezolucioni hapësinor (pitch): 75 mikrometra, Efektiviteti është >99% për rrezatim Cr dhe Co, >98% për Cu rrezatim, 40% për rrezatim të Mo dhe 20% për rrezatim të Ag, Shpërndarja e energjisë <680 eV për rrezatim të Cu, gjenerator 27.12 MHz për gjenerim të plazmës, Temperatura kontrollohet nga -15 °C deri në temperaturë të dhomës, i izoluar me shkumë polipropilen, Pompë peristatike e kontrolluar nga PC-ja, me shpejtësi 0-50 rpm, tri kanale të pavarura të presionit të rregullueshme për mostër, pastrim dhe stanarde interne apo diluent, 27.12 MHz RF gjenerator i ngurtë, ftohet me ajër, i mbyllur me Kristal në shtëpizën kryesore 300–1600 W me 10 W shkallë, Bord shumëkanalësh i cili ofron deri në 40 kanale për mass, Rangu nga 3 deri në 256 amu me mbrojtje “zero shpërthim”. Rregullim i rezolucionit nga 0.5 deri 1.2 amu, Stabiliteti i kalibrimit të Mass-it: 0.05 amu per ditë, Quadrupole RF frequency: 3.0 MHz, Shpejtësia e skanimit: 2000 amu/s, Gryka diametër: 1.1 mm mostruesit, 0.5 mm ndarës, High-speed Time Resolved Signal (TRS) mundësisë për bashkëveprim me teknika tjera ndarëse si HPLC apo integrim LC-ICP-MS, Listë të editueshme të mostrave deri në 1000 mostra për listës së analizës etj. Specifikimet teknike që duhet ti kenë këto pajisje janë specifikuar nga Autoriteti kontraktues në atë mënyrë që i

përshtatën prodhuesit *Bruker dhe analytikjena* dhe eliminojnë prodhuesit tjerë të këtyre pajisjeve.

Autoriteti kontraktues më konkretisht Njësia Kërkuese duhet të ketë kujdes dhe t'i përpilojë specifikimet teknike apo termat e referencës në atë mënyrë që ato të mos jenë me vlera fikse, por të caktohet një minimum i kërkesave teknike në mënyrë që të jenë të hapura për të gjithë operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimet me pajisje të tilla laboratorike. Njësia kërkuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formuloj specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë ti diskriminoj Operatorët tjerë ekonomik, si dhe të mos caktoj kërkesa të cilat do ti pengonin operatorët ekonomik për të dorëzuar tenderët e tyre.

Agjencia Kundër Korrupsionit gjithashtu ka gjetur se tek pjesa e Sigurisë më konkretisht tek Sistemi Difraktometer është kërkuar që Sistemi duhet të ketë *“aprovimin e tipit” të dhënë nga Instituti Gjerman Kombëtar i Metrologjisë* në konsideratë për sigurinë nga rrezet X. Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj që pajisja të jetë e kualitetit të lartë apo ti referohet një standardi vendor, europian ose ndërkombëtar për furnizim me këto pajisje, por assesi nuk lejohet të kërkohej nga ndonjë vend i caktuar.

Gjatë analizimit të dosjes së këtij tenderi dhe vlerësimit të tenderëve, AKK konstaton se bëhet fjalë për 5 pajisje të ndryshme dhe se të gjithë ofertuesit për këtë kontratë kanë ofruar nga 5 autorizime nga prodhues të ndryshëm për pajisjet e kërkuara. Me këtë Agjencia konstaton se ky tender mund të ndahet edhe në lote, pasi që jo domosdoshmërisht 5 pajisjet duhet të jenë nga i njëjti prodhues. Lidhur me këtë zyrtari përgjegjës i AKK-së e ka pyetur edhe Kryesuesin e Komisionit i cili me profesion është Gjeolog dhe i cili ka theksuar se bëhet fjalë për 5 pajisje të ndara njëra me tjetrën të pavarura dhe nuk është domosdoshmërisht obligative të jenë pajisjet nga i njëjti prodhues.

Autoriteti Kontraktues me dt.06.08.2015 ka bërë Anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se janë pranuar më pakë se dy oferta të përgjegjshme, njoftimi për anulimin është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së. Njëri nga Operatorët ekonomik i cili është eliminuar gjatë fazës së vlerësimit ka bërë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit kundër Njoftimit për anulim të datës 06.08.2015. Organi Shqyrtues i Prokurimit me dt.02.09.2015 ka nxjerrë vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e Operatorit ekonomik ankues dhe e ka aprovuar vendimin për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimit i tenderëve nga ana e Komisionit vlerësues është kryer në mënyrë profesionale dhe konform nenit 59 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik, megjithatë kërkesat teknike të hartuara në Dosjen e tenderit nuk janë në pajtim me LPP-në.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi dhe nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Agjencia kundër Korrupsionit kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë korrigjimin e Specifikimeve teknike dhe të procedojë me këtë aktivitet të prokurimit konform Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik .

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !